

AKT - THEMELUES

KONTRATE

E

SHOQERISE SHQIPTAR0-BULLGARE "SELAS" (shpk) ME QENDER NE TIRANE (SHQIPERI)

Ne kompletim te KONTRATES per krijimin e Shoqerise se Perbashket Shqiptaro- Bullgare "SELAS", Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, rregjistruar me vendimin Nr.4682, date 28/5/1993,

Ne mbeshtetje te nenit 2/paragrafi 1, shkronja 9, te Ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe veprimtarise private", Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar per shoqerite tregtare",

Per drejtimin dhe administrimin e shoqerise ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar si dhe per ceshnje qe kane lidhje me organizimin dhe funksionimin e saj.

Subjektet :

Perfaqesuesi i pales shqiptare z. Vladimir Agalliu dhe, perfaqesuesi i pales bullgare z. Ljubomir Kjudikov, themelues te shoqerise, duke patur zotesine e plote juridike per te vepruar, rane dakort dhe kontraktuan per sa vijon:

PARIMET E PERGJITHSHME TE ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqeria e perbashket me pergjegjesi te kufizuar e perbere nga:

1. **Vladimir Agalliu**, lindur ne Berat, me 25.5.1948 banues ne Tirane, rruga "P. N. Luarasi" , P 14/5 Nr 1
2. **Ljubomir Kjudikov**, lindur ne Sofje, Bullgari, me 14/6/1955, banues po aty, ne adresen Sofje, 29, Siderovskica, e cila rregjistrohet si subjekt juridik dhe ushtron veprimtari private ne baze te kesaj Kontrate, te Statutit bashkangjitur dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "SELAS", Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (shpk).

SELIA

Neni 3

Shoqeria "SELAS" (sh.p.k.) e ka seline ne Tirane, me adrese (te perkohshme): Rruga "L. Gj. Gurarasi, 11" dhe mund te ndryshoje adrese ne pershtatje me veprimtarine dhe nevojat e saj. Ajo ka te drejte te hapi dege (filiale), zyra perfaqesimi etj ne rrethe te ndryshme te Shqiperise, ose ne ven-

te huaja ne perputhje me nevojat e veprimtarise se saj,mbeshtetur ne legjislacionin perkates.

Neni 4

Shoqeria "SELAS" fiton zotesine per te vepruar dhe personalitetin juridik me rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar ne Gjykatën e rrethit Tirane dhe me rregjistrimin e paisjen me vendimin nga organi tatimor perkates.

"SELAS" merr vendime ne zbatim te ligjit ne fuqi, te kesaj Kontrate dhe te Statutit, qe jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithë te punesuarit ne kete shoqeri.

Ajo ka vulen e saj me permbajtjen: "Shoqeria e perbashket Shqiptaro-Bullgare SELAS- Albania"

KOHEZGJATJA

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "SELAS" (sh.p.k.) eshte e pa kufizuar dhe mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "SELAS" (sh.p.k.) eshte si me poshte:

- Veprimtari tregtare import - eksport dhe shitje me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore, farmaceutike, te materialeve te ndertimit, artkuj bujqesore e prodhime pyjore, leter shtypi dhe materiale te shtypit, paisje , maqineri dhe linja te llojeve te ndryshme , kimikate, autovetura, mjete transporti e pjese nderrimi te tyre, artkuj social-kulturore, artistike, libra e revista. pije, cigare, veshmbathje etj.

- Investime dhe veprimtari prodhuese e perpunuese ne fushat e ndertimit e te materialeve te ndertimit, te artikujve ushqimore, industriale etj.

- Veprimtari tregtare komisionere, konsultimi, reklame, marketingu, transporti, kembimi te valutave te ndryshme etj.

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali fillestar i Shoqerise "SELAS" eshte 200.000 leke i investuar nga dy subjektet themelues si me poshte:

Pala shqiptare -50 % te kapitalit, ose 100.000 leke.

Pala bullgare -50 % te kapitalit ose 100.000 leke.

Kuotat e kapitalit te çdo pale qe jane ne natyre do t'i dorezohen shoqerise brenda afatit te caktuar nga te dy palet.

Neni 8

Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandashme. ato nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe pastaj ndahen midis paleve ne perpjestim me kuotat e kapitalit te secilit ne formimin e kapitalit

themelor te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themelor mund te transferohen vetem me pelqimin e ortakeve, duke evidentuar me shkrim ndryshimet ne regjistrin tregtar dhe formalitetet per ndryshimin e statutit.

ORGANET DREJTUESE

Neni 9

Organet drejtuese te Shoqerise "SELAS"(sh.p.k.) jane: -Asamblea e ortakeve ,e perbere nga dy perfaqesuesit e paleve themeluese ,e cila perben edhe keshillin drejtues te shoqerise se perbashket.

-Administratore do te jene dy perfaqesuesit e shoqerise se perbashket. Ata drejtojne shoqerine bashke dhe vec e vec.

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e punes e organeve drejtuese, kompetencat e administratoreve (drejtuesave) dhe te punonjesve te emeruar ne shoqeri miratohen nga asamblea e ortakeve. Ceshtje te tjera te rendesishme te ketyre organeve rregullohen sipas statutit te shoqerise, si dhe me rregullore te tjera te brendshme qe ne çdo rast miratohen nga Asamblea e ortakeve.

Neni 10

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese jane miratuar nga te dy ortaket ne forme shkrese. Si forme shkrese do te quhet edhe miratimi i dhene me teleks ose faks.

Secili prej drejtuesave do te kete te drejten e vendimeve te pavarura per shuma deri ne 20.000 (njezet mije) USD.

Neni 11

Ne drejtimin dhe organizimin e shoqerise se perbashket (shpk) secili nga drejtuesit ka te drejta te barabarta.

Drejtuesi shqiptar dhe bullgar do te kryejne veprimtarine e tyre secili ne teritorin e vendit te vet, perkatesisht Shqiperi dhe Bullgari si dhe perkatesisht do te sigurojne zgjidhje te problemeve te eksportit e importit, te plotsimit dhe respektimit te formaliteteve doganore, te gjetjes se mallrave, interesin etj.

Ne se ndonjeri prej drejtuesave me veprimet e veta shkel ligjet ne fuqi, per drejtuesin shqiptar-ligjet shqiptare dhe per drejtuesin bullgar-ligjet bullgare, per kete do te mbaje pergjegjesi secili per vete (ligjet e vendit te vet).

Shoqeria zbaton dhe dispozitat urdheruese te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 12

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj ekonomiko-tregtare ne perputhje me legjislacionin e shtetit shqiptar dhe, per veprimet e import exportit qe kryhen ne Bullgari ose ne shtete te tjera, konform ligjeve te shteteve perkatese.

Neni 13

Shoqeria cakton ne menyre te pavarur cmimet dhe tarifat e mallrave, te sherbimeve etj ne perputhje me kerkesen e oferten.

Ajo eshte pronare e ligjshme e fondeve, mjeteve dhe e gjithë pasurise se shoqerise qe e ka gjendje ose qe do ta krijoje.

Neni 14

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen me 31 dhjetor te çdo viti. Ne fund te çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabel i shoqerise me rezultatin ekonomik- humbje- fitime, bazuar ne ligjet dhe rregullat e mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet ekonomike, duke nxjerre gjithashtu inventaret perkatese dhe raportin mbi administrimin.

Shoqeria, nepermjet pales shqiptare do te paraqese bilancin vjetor se bashku me deklaraten per te adhurat, humbjet e fitimin te cilat i depoziton ne organin perkates tatimor te Tiranës.

Ne menyre te pavarur nga kjo, shoqeria do te pregatise dhe bilancin per cdo tremujor , i cili do te jete i perkthyer gjuhen angleze per partnerin bullgar.

Bilanci kontabel vjetor miratohet nga Asamblea e shoqerise brenda 31 marsit te vitit pasardhes. Me miratimin e bilancit vjetor Asamblea vendos per krijimin e fondeve te ndryshme, te nevojshme per zhvillimin e garantuar te saj, si fondin rezerve, fondin e akumulimit etj.

Neni 15

Fitimi i realizuar nga shoqeria mbas veçimit te fondeve dhe shlyerjes se detyrimeve fiskale ndahet ndermjet ortakeve sipas raportit te kuotave te kapitalit.

Neni 16

Ne baze te legjislacionit shqiptar pala bullgare ka te drejte te kaloje ne Bullgari pjjesen e saj te kapitalit dhe pjesen e e fitimit ne valute te konvertueshme.

MAREDHENIET E PUNES

Neni 17

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen ne baze te statutit te saj.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 18

Shperberja e shoqerise mund te vije ne çdo kohe dhe per çdo shkak duke vepruar sipas kriterëve qw pershkruhen ne statutin e saj.



DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 19

Te gjitha mosmarrveshjet e debatet e çdo lloj natyre qe burojne ose i perkasin kesaj kontrate, ose qe kane te bejne me prishjen, perfundimin apo pavlefshmerine e saj, zgjidhen nga Gjykata e rrethit te Tiranes, vendimet e se ciles jane te detyrueshme per palet.

Neni 20

Ne mbeshtetje te kesaj kontrate, veprimtaria e shoqerise, drejtimi, kontrolli, probleme te trashigimise, te sekretit te punes e te tjera, do te behen ne perputhje me kriteret perkatese te percaktuara ne statut.


Neni 18

Ky akt themelues perpilohet ne gjuhen shqipe e bullgare. Te dy tekstet jane zyrtare. Gjithashtu perpilohet ne disa kopje per t'i paraqitur ne organet kompetente shqiptare si dhe nje kopje qe mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

Akti hyn ne fuqi dite nenshkrimt te tij nga perfaqesuesit e subjekteve themelues te shoqerise.

Per palen Bullgare

Ljubomir Kjurikov



Per palen Shqiptare

Vladimir Agalliu



Tirane, me 27.12.1993

STATUT
I
SHOQERISE SHQIPTARO-BULLGARE "SELAS"(shpk)
ME QENDER NE TIRANE (SHQIPERI)

Ne kompletim te STATUTIT te Shoqerise se Perbashket Shqiptaro- Bullgare "SELAS", Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, rregjistruar me vendimin Nr.4682, date 28/5/1993,

Ne mbeshtetje te nenit 2/paragrafi 1, shkronja 9, te Ligjit nr.7512, date 10.08.1991 "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, nismes se lire dhe veprimtarise private", Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar per shoqerite tregtare",

Per drejtimin dhe administrimin e shoqerise ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar si dhe per ceshtje qe kane lidhje me organizimin dhe funksionimin e saj.

Subjektet juridike :

Pperfaqesuesi i pales shqiptare z. Vladimir Agalliu dhe perfaqesues i pales bullgare z.Ljubomir Kjucikov, themelues te shoqerise, duke patur zotesine e plote juridike per te vepruar, rane dakort qe shoqeria Selas te ndertohet, funksionojë e te drejtohet ne baze te ketij **STATUTI**

PARIMET E PERGJITHSHME TE ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT
FORMIMI

Neni 1

Formohet shoqeria e perbashket me pergjegjesi te kufizuar e perbere nga:

1. Vladimir Agalliu, lindur ne Berat, me 25/5/1948 banues ne Tirane, rruga "P. H. L. ...",
P. 10/1 Nr 1
2. Ljubomir Kjucikov, lindur ne Sofje, Bullgari, me 14/6/1955, banues po aty, ne
adresen "Sofje, Silavovsk, Nr 28"

Shoqeria e perbashket (shpk) rregjistrohet si subjekt juridik dhe ushtron veprimtari private ne baze te Kontrates se arritur mes dy paleve, te ketij Statuti dhe ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "SELAS", Shoqeri me Pergjegjesei te Kufizuar (shpk).



SELIA

Neni 3

Shoqeria "SELAS" (sh.p.k.) e ka seline ne Tirane, me adrese (te perkohshme): Rruga Leif S. J. 100, Nr. 11 dhe mund te ndryshoje adrese ne pershtatje me veprimtarine dhe nevojat e saj. Ajo ka te drejte te hapi dege (filiale), zyra perfaqesimi etj ne rrethe te ndryshme te Shqiperise, ose ne vende te huaja ne perputhje me nevojat e veprimtarise se saj, mbeshketur ne legjislacionin perkates.

Neni 4

Shoqeria "SELAS" fiton zotesine per te vepruar dhe personalitetin juridik me rregjistrimin ne Rregjistrin Tregetar ne Gjykatën e rrethit Tirane dhe me rregjistrimin e paisjen me vendimin nga organi tatimor perkates.

"SELAS" merr vendime ne zbatim te ligjit ne fuqi, te Kontrates dhe te Statutit, qe jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithë te punesuarit ne kete shoqeri.

Ajo ka vulen e saj me permbajtjen: "Shoqeria e perbashket Shqiptaro-Bullgare SELAS- Albania"

KOHEZGJATJA

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise "SELAS" (sh.p.k.) eshte e pa kufizuar dhe mbi 10 vjet.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Neni 6

Objekti i veprimtarise se Shoqerise "SELAS" (sh.p.k.) eshte si me poshte:

- Veprimtari tregtare import - eksport dhe shitje me shumice e pakice te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, farmaceutike, te materialeve te ndertimit, artikuj bujqesore e prodhime pyjore, materiale e lende energjitike, leter shtypi dhe materiale te shtypit, paisje, maqineri dhe linja te llojeve te ndryshme, kimikate, autovetura, mjete transporti e pjese nderrimi te tyre, artikuj social-kulturore, artistike, libra e revista, pije, cigare, veshmbathje etj.

- Investime dhe veprimtari prodhuese e perpunuese ne fushat e ndertimit e te materialeve te ndertimit, te artikujve ushqimore, industriale etj.

- Veprimtari tregtare komisionere, konsultimi, reklame marketingu, transporti, kembimi te valutave te ndryshme etj

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7

Kapitali fillestar i Shoqerise "SELAS" eshte 200.000 leke i investuar nga dy subjektet themelues si me poshte:

Pala shqiptare -50 % te kapitalit, ose 100.000 leke.

Pala bullgare -50 % te kapitalit ose 100.000 leke.

Kuotat e kapitalit te çdo pale qe jane ne natyre do t'i dorezohen shoqerise brenda afatit te caktuar nga te dy palet.

Neni 8

Kuotat e pjesemarrjes ne kapital jane te gjitha te emertuara e te pandashme, ato nenshkruhen, shlyhen plotesisht dhe pastaj ndahen midis paleve ne perpjestim me kuotat e kapitalit te secilit ne formimin e kapitalit themelor te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themelor mund te transferohen vetem me pelqimin e ortakeve, duke evidentuar me shkrim ndryshimet ne regjistrin tregtar dhe formalitetet per ndryshimin e statutit.

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve qe marrin ortakët.

Ne asnje rast njeri nga ortakët nuk mund te detyroje ortakun tjete te rrisi angazhimin e tij ne kapitalin e shoqerise.

Shoqeria mund te zvogeloje kapitalin e saj, zvogelim i cili prek te gjithë ortakët ne te njejtin perpjestim me kuoten e tyre ne kapitalin e shoqerise.

Pjeset e kapitalit themelor jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

ASAMBLEA

Neni 9

Asambleja e ortakeve te shoqerise "SELAS" (sh.p.k.) perbehet nga ortakët: Vladimir Agalliu dhe Ljubomir Kjucikov.

Asambleja eshte organ sovran i shoqerise. Themeluesit administrojne veprimtarine e saj duke u mbeshtetur ne te drejtat e tyre te pronesise dhe mbi mjetet e investuara ne shoqeri.

Te zgjedhurit dhe te emeruarit nga Asambleja veprojne ne perputhje me aktin themelues (kontraten) dhe statutin e shoqerise si dhe me ligjet ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Vendimet qe merr Asambleja sipas ketij statuti ,dhe dispozitave ligjore ne fuqi jane te detyrueshme per ortakët.

Vendimet e Asamblese mund te merren edhe nepermjet konsultimeve me shkrim, nese nje nga ortakët nuk ka kerkuar mbledhjen e asamblese. Per te gjitha çështjet e shqyrtuara nga Asambleja mbahet proces-verbal ne nje regjister te veçante.

Asambleja mbledhet zakonisht dy here ne vit, ne nentor per te miratuar programin ekonomik per vitin e ardhshem dhe ne mars per te miratuar bilancin kontabel te vitit te meparshem,por kur lind nevoja, mbledhet edhe me shpesh,per te vendosur per probleme e detyra qe jane ne kompetence te saj.

Mbledhja e Asamblese ka keto kompetenca:

- Ben ndryshime e plotesime ne kontraten dhe statutin e shoqerise.
- Ben ndryshime ne kapitalin themelor dhe kuoten e pjesemarrjes se ortakeve.
- Miraton rregulloret e brendshme per detyrat e organeve drejtuese ekzekutive te shoqerise.
- Miraton bilancin kontabel vjetor, raportin mbi gjendjen e shoqerise, ndarjen e dividenteve, krijimin e fondeve te shoqerise, si dhe prekjen e tyre ne rast nevojë.
- Miraton anetaret e komisionit te revizionimit, sferen e veprimtarise se tyre, si dhe pagen ose honorarin qe u takon.
- Merr vendime per krijimin dhe nderprerjen e veprimtarive te filialeve dhe te agjensive, si dhe ben

shkurtime apo zgjatje te afatit te veprimtarise se shoqerise.

- Miraton marreveshje te ndryshme perfshi ketu edhe shitblerje, dhenie apo marrje me qira, kembime ose tjeterperdorim te pasurise se shoqerise.

- Vendos per bashkim ose ndarje me shoqeri te tjera.

- Vendos per ndryshime te formes organizative apo pasurore te shoqerise.

- Vendos per likujdimin e shoqerise, krijimin e komisionit te likujdimit dhe miraton konkluzionet e shperberjes se shoqerise.

Neni 10

Secili ortak qe ka te drejten e pjesemarrjes ne Asamble mund te perfaqesohet ne te edhe nga nje person tjeter i autorizuar me shkrim prej tij.

Neni 11

Asambleja e shoqerise ne se lind nevoja drejtohet nga administratori i pergjithshem, i cili caktohet nga asambleja e ortakeve.

Neni 12

Vendimet e Asamblese jane te vlefshme nese jane pranuar nga te dy ortaket.

Neni 13

Largimi i nje ortaku nga shoqeria, mund te behet duke paraqitur kerkesen me shkrim ne nje afat prej 6 muaj me pare.

Me qe shoqeria perbehet nga dy ortake, ne rastet kur njeri kerkon te largohet, pala (ortaku) tjeter ka te drejte qe te gjeje nje ortak tjeter ne vendin e ortakut qe kerkon te largohet me te cilin te vazhdoje veprimtarine e shoqerise. Ne nje rast te tille, ortakut qe largohet mund te terheqi pjesen e tij te kapitali te derdhur si kapital themeltar, por kjo jo me pare se 1 (nje) gjer 6 (gjashte) muaj nga largimi dhe zevendesimi i tij me nje tjeter. Pas largimit ky ortak nuk gezon te drejtat e ortakut. Me largimin e tij nga shoqeria, ortakut nuk lirohet nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise. Maredheniet e shoqerise me ortakun e larguar, duhen zgjidhur brenda nje viti nga data e paraqitjes se doreheqjes.

Shoqeria mund te vazhdoje veprimtarine edhe kur vdes nje ortak. Per kete ruhen te drejtat dhe detyrimet duke vendosur ne mes ortakut tjeter dhe trashegimteneve te ortakut te vdekur. Nese keta te fundit nuk deshirojne te futen ne shoqeri, ose jane te paafte, mund te vendoset blerja e se drejtes trashegimore te ortakut te vdekur nga nje ortak tjeter. Ne kete drejtim veprohet brenda nje afati nje vjeçar, ne te kunderten shoqeria priset.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 14

Shoqeria "SELAS." (sh.p.k.) deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban akti themelues dhe statuti i saj, si dhe ne baze te normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria zbaton edhe dispozitat normative dhe urdheruese te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe ligjit 7667 date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe rregullat qe duhen zbatuar nga shoqerite tregtare".

Shoqeria "SELAS." (sh.p.k.) fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj si person juridik ne

regjistrin tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane dhe e ushtron aktivitetin ekonomik me regjistrimin e saj si subjekt privat ne organin perkates tatimor te Tiranes.

Neni 15

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen "Shoqeria "SELAS"(sh.p.k.) Tirane."

Neni 16

Shoqeria merr vendime ne zbatim te ligjit ne fuqi ,te kontrates (Aktit Themelues)dhe te ketij statuti, qe jane te detyrueshme per zbatim nga te gjithë te punesuarit ne kete shoqeri.

Neni 17

Sipas nevojave te saj bazuar ne rregullore te brendshme, shoqeria puneson punetore dhe emeron administratore, te cilet qendrojne ne detyre derisa revokohen ose largohen me deshiren e tyre si dhe kur mbaron afati i kontrates se punes.

Neni 18

Administratori i pergjithshem si dhe administratoret e emeruar ose te autorizuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem te shoqerise. Ne kete rast administratori i emeruar eshte i detyruar t'i jape llogari administratorit te pergjithshem.

MAREDHENIET E PUNES

Neni 19

Cdo te punesuari ne shoqeri i percaktohen ne aktin e emerimit detyrat dhe paga, apo menyra e shperblimit. Shoqeria merr persiper qe gjithë te pûnesuarit te respektojne ligjet ne fuqi te punesimit e te sigurimeve shoqerore, ndersa te gjithë te punesuarit jane te detyruar te pranojne statutin e shoqerise.

Kriteret dhe kufijte e pagave per te gjithë te punesuarit caktohen nga asamblea.

Neni 20

Maredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. per çeshtjet qe nuk rregullohen nga kontrata e punes, zbatohen dispozitat perkatese te legjislacionit shqiptar.

Neni 21

Te punesuarit ne shoqeri pergjigjen sipas ligjit dhe ketij statuti per mos zbatim te detyrave dhe per demet qe i sjellin shoqerise.

Neni 22

Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria.

Neni 23

Administratori i emeruar nuk mund te marre cilesine e ortakut dhe as te ushtroje nje aktivitet konkurues per llogari te tij apo te te treteve perveç atyre te autorizuar nga administratori i pergjithshem. Per çdo shkelje ne kete drejtim, administratori largohet nga puna dhe pergjigjet per demet shkaktuar shoqerise.

SEKRETI I PUNES

Neni 24

Te gjithë te punesuarit janë te detyruar te ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Sekret pune paraqesin shkresat, materialet dhe akte të cilat me ligje e dispozita të veçanta si dhe me vendimet e nejjera nga ortaket e shoqërisë janë shpallur sekret pune.

Detyra mbi ruajtjen e sekretit të punës nga te punesuarit vazhdon edhe mbas largimit të tyre nga puna.

PERFAQESIMI I SHOQERISE

Neni 25

Perfaqesimi i shoqërisë "SELAS" (sh.p.k.) i perket administratorit të përgjithshëm të saj, si dhe personit të autorizuar prej prej ortakeve ose prej adminisrtatorit të përgjithshëm. Ata kanë të drejtë të perfaqesojnë shoqërinë para të treqëve si dhe në organe gjyqësore.

KONTROLLI I BRENDSEHEM

Neni 26

Shoqëria e organizon kontrollin e brendshëm me një ose me shumë eksperte kontabel të autorizuar ose percaktuar për tre vjet me mundësi rizgjedhje ose pushim nga puna.

BILANCI DHE TE ARDHURAT

Neni 27

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me 31 dhjetor të çdo viti. Në fund të çdo periudhë ushtrimore administratori i ngarkuar nxjerr bilancin kontabel të shoqërisë me rezultatin ekonomik humbje fitime inventare e raporte perkatese, bazuar në ligjet dhe rregullat për mbajtjen e kontabilitetit.

Bilanci kontabel vjetor miratohet nga asambleja e ortakeve brenda 31 marsit të vitit pasardhës. Me miratimin e bilancit kontabel shoqëria vendos për krijimin e fondeve të ndryshme.

Neni 28

Te ardhurat neto, pas veçimit të fondeve dhe shlyerjes së detyrimeve fiskale, i mbesin për përdorim ortakeve dhe ndahen ndërmjet tyre në përputhje me raportin e kuotave të kapitalit ndaj kapitalit themelor të shoqërisë.

SHPERBERJA E SHOQERISE

Neni 29

Shperberja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak, si mbarim afati, humbje e kapitalit, force madhore, pamundësi veprimtarie dhe gjithnjë me vendim të Asamblese së shoqërisë. Në këte rast ortaket vendosin mbi menyrat e likuidimit dhe caktojnë një ose me shumë likujdatore, duke percaktuar edhe detyrat e tyre.

Likujdatori eshte pergjegjes per detyrat e likujdimit. Ai ka per detyre te kujdeset qe te likujdoje ne radhe te pare detyrimet e shoqerise ndaj te treteve.

Mbas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themelor, likujduesi ndan kapitalet e mbetura ne mes ortakeve, perpjestimisht me kuotat qe ata zoterojne ne kapitalin themelor. Ne fund te procesit te likujdimit Asamblea vendos unanimisht mbi bilancin perfundimtar, mbi rregullshmerine e punes se likujduesit dhe mbi mbylljen e procesit te likujdimit.

Me rastin e likujdimit te shoqerise, emertimi i saj do te pasohet nga shenimi "Shoqeri ne likujdim e siper".

Mbasi behet njoftimi i mbylljes se likujdimit dhe kryhen formalitetet e likujdimit, shoqeria  rregjistrohet nga regjistri tregtar i Gjykates se rrethit Tirane.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 30

Persa nuk eshte shprehur plotesisht ne kete statut, i referohet plotesimeve nga Asamblea dhe ligjeve te ve anta te legjislacionit shqiptar.

Ndryshimet e plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen krijohet vete statuti dhe si  kerkohet nga ligji nr.7667 date 28.01.1993. Ndryshimet miratohen nga te gjith  ortaket. Cdo ndryshim nuk prek personalitetin juridik te shoqerise.

Neni 31

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'  paraqitur para organeve kompetente qe do te bejne te mundur fillimin e aktivitetit te shoqerise. Statuti perpilohet ne gjuhen shqipe, italiane e maqedonase. te tre tekstet jane zyrtare.

Neni 32

Ky statut hyn ne fuqi dite  e nenshkjimit te tij nga ortaket themelues te shoqerise bashke me aktin themelues (Kontraten).

Ortaket themelues

Per palen Bulgare

Ljubomir KJUCIKOV

Per palen Shqiptare

Vladimir AGALLIU